

D E K R E T
Nr.1675, datë 24.12.1996

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE PARTIVE POLITIKE PJESËMARRËSE NË
ZGJEDHJE**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

D E K R E T O J:

Neni 1

Partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e datës 26 maj 1996 për deputetët e Kuvendit Popullor ose në zgjedhjet e datës 20 tetor 1996 për organet e pushtetit lokal, u falen detyrimet financiare ndaj buxhetit të shtetit që rrjedhin nga zbatimi i nenit 58 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1991, i ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 1.2.1996 dhe i nenit 49 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992, me ndryshimet e mëvonshme.

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha